



FOTOT: ARKIVA E SPT

BULETINI - PËRMIRËSIMI I BASHKËPUNIMIT

IPA Programeve të Bashkëpunimit
ndërkufitar Mali i Zi - Shqipëri dhe
Mali i Zi - Kosovë 2014- 2020

Gusht 2018

PËRMBAJTJA

Edicioni i dytë i buletinit të programeve IPA BNK MZ-SHQ dhe MZ-KOS

Edicioni i dytë i buletinit ju sjell informacione mbi aktivitetet e zbatuara në kuadër të dy programeve IPA BNK Mali i Zi – Shqipëri dhe Mali i Zi - Kosovë* 2014-2020.

Më shumë informacione për programet mund t'i gjeni më poshtë.

Programi IPA i BNK Mali i Zi - Shqipëri 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të promovojë dhe të forcojë marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe zhvillimin socio-ekonomik të rajoneve kufitare, përmes valorizimit të potencialeve turistike dhe një zhvillimi ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

Programi IPA i BNK-së Mali i Zi - Kosovë 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të përmirësojë standardet dhe cilësinë e jetës së njerëzve në zonën e programit nëpërmjet zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të rajonit në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

Ky publikim është prodhim i mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi e Sekretariatit të Përbashkët Teknik të Programeve IPA BNK Mali i Zi – Shqipëri dhe Mali i Zi – Kosovë 2014-2020 dhe nuk paraqet domodoshmerisht mendimet e Bashkimit Evropian.

- »»» Programi IPA BNK Mali i Zi - Shqipëri 2014-2020 - Ceremonia për Shpalljen e Projekteve fituese.....2
- »»» Takimet Tematike janë mbajtur në 30 komuna/bashki të të dy zonave të programit.....3
- »»» Ndryshimet në strukturën operuese të Malit të Zi3
- »»» Projektet e financuara në kuadër të thirrjes së parë për projekt propozime të programit IPA BNK Mali i Zi – Shqipëri 2014-2020.....4
- »»» Hapet zyra a Antenës në Prishtinë6
- »»» Instrumenti për Kërkimin e Partnerëve6
- »»» Takime të organizuara në kuadër të programeve IPA BNK MZ-SHQ dhe MZ-KOS 2014 – 2020.....7
- »»» Aktivitete për rritjen e kapaciteteve për Përfituesit e projekteve7
- »»» Aktivitete për rritjen e kapaciteteve për Aplikuesit potencial.....8
- »»» Versioni i ri i PRAG!8
- »»» Programi i punës për Grantet i programit IPA BNK Mali i Zi – Shqipëri.....8

* Ky shënim është pa paragjykim të pozicioneve për status dhe është në linjë me RKS KB 1244 dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.



Ky projekt është i financuar nga Bashkimi Evropian



MNE - ALB

IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - SHQIPËRI 2014-2020



MNE - KOS

IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - KOSOVË 2014-2020

Programi IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri 2014-2020 - Ceremonia për Shpalljen e Projekteve Fituese

Ceremonia për shpalljen e projekteve të kontraktuara në kuadër të thirrjes së Parë të programit IPA BNK MZ-SHQ 2014-2020 u organizua në Shkodër me qëllim prezantimit dhe promovimit të projekteve fituese.



Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë, **Gazmend Barbullushi**, mbajti fjalën hapëse të konferencës duke theksuar bashkpunimin cilësor ndërmjet Malit të Zi dhe Shqipërisë dhe duke falenderuar Strukturën Operuese të Malit të Zi, Sekretariatit e Përbashkët Teknik dhe Delegacionin e Bashkimit Evropian në Mal të Zi për përpjekjen e përbashkët që rezultoi në kontraktimin e suksesshëm të 8 projekteve brenda Thirrjes së Parë. Ai gjithashtu falenderoi përfituesit e projekteve për përpjekjet e sukseshme në përgatitjen e projekt propozimeve të mira dhe i kujtoi atyre se zbatimi i përbashkët i të gjithë projekteve të kontraktuara është një mundësi reale për të kontribuar në bashkpunimin eficient ndërmjet dy shteteve.

Numri i partnerëve




Ivana Glisheviq Gjuroviq në emër të Strukturës Operative të Malit të Zi, theksoi se Komisioni Evropian i besoi Malit të Zi menaxhimin e fondeve të Programit dhe se këto janë projektet e para të kontraktuara në kuadrin e programeve bilaterale të IPA II që



po zbatohen në menaxhimin indirekt dhe kjo paraqet një nder të madh dhe afirmimin e rezultateve të mira, si dhe njohjen e pjekurisë dhe përgjegjësisë së Malit të Zi në proceset integruese.

Ajo ka theksuar se zbatimi i këtyre projekteve do të sjelli rezultate konkrete dhe të dukshme në të dy shtetet, do të vendosin partneritet afatgjatë dhe të qëndrueshëm, si dhe do të avancojnë standardin dhe cilësinë jetësore të njerëzve në zonën e programit. Ajo gjithashtu ka vënë në dukje se projektet mbulojnë 15 komuna/bashki nga zona e programit dhe që në zbatimin e projekteve do të marrin pjesë 30 institucione partnere.

Kontraktuar për Prioritet Tematik



Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë për Financimin dhe Kontraktimin e fondeve të BE-së në Ministrinë e Financave të Malit të Zi, **Bojan Paunoviq**, ka vlerësuar që bashkëpunimi cilësorë me Strukturat Operuese dhe Delegacionin e Bashkimit Evropian në Mal të Zi ka kontribuar që sot të

promovohen projektet në kuadër të thirrjes së parë të IPA Programit të bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi- Shqipëri. Ai i ka informuar të pranishmit që 8 projektet e kontraktuara në këtë thirrje arrijnë vlerën prej 2.7 million euro.

Donata von Sigsfeld, Udhëheqësja e programit në Delegacionin e Bashkimit Evropian në Mal të Zi vlerësoi punën e strukturave Operuese dhe të Sekretariatit të Përbashkët Teknik dhe dhe vlerësoi se autoriteti kontraktues në Malin e Zi ka punuar shumë në procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes së propozimeve për financim në kuadër të kësaj thirrje. Ajo vlerësoi ceremoninë si një moment të rëndësishëm të bashkëpunimit territorial ndërmjet Malit të Zi dhe Shqipërisë të cilët janë të njohur gjërësisht që sjellin cilesi më të mire jetese për popullsinë lokale. Këto iniciativa ndërkufitare do mbështesin fuqishëm përpjekjet për zhvillim të popullsisë lokale në zonat kufitare të Malit të Zi dhe Shqipërisë, dhe do promovojnë vlerat e përbashkëta Evropiane siç janë ato të besimit, respektit reciprok dhe bashkpunimit.

Në pjesën e dytë të ceremonisë, Drejtuesja e Sekretariatit të Përbashkët Teknik, **Sanja Todorović**, prezantoi shkurtimisht procesin e thirrjes së Parë për projekt propozime. Ajo informoi audiencën mbi aktivitetet e zbatuara nga Strukturat Operuese të programit lidhur me rritjen e kapaciteteve të aplikuesve potencial para dhe pas publikimit të thirrjes.

Sesioni i tretë i ceremonies ju dedikua prezantimit të 8 projekteve të kontraktuara që do zbatohen gjatë 36 muajve të ardhshëm (më shumë detaje gjeni në faqen 6).

Takimet Tematike janë mbajtur në 30 komuna/bashki të të dy zonave të programit

Në periudhën ndërmjet datës 19 shkurt deri me 26 mars, Sekretariati i Përbashkët Teknik (SPT) i programeve IPA II BNK Mal i Zi - Shqipëri dhe Mal i Zi - Kosovë 2014-2020 ka organizuar takime tematike dhe vizituan 30 bashki nga zona e programit në Mal të Zi (15), Shqipëri (9) dhe Kosovë (6). Takimet tematike u organizuan me përfaqësuesit e bashkive dhe institucioneve/ndërmarrjeve lokale.



Ekipi i Sekretariatit të Përbashkët Teknik, përfaqësuesit e Strukturave Operuese të Malit të Zi (në komunat në Mal të Zi), Shqipërisë (në bashkitë në Shqipëri) dhe Kosovë (në komunat në Kosovë) si dhe përfaqësuesit e Delegacionit të BE-së në Malin e Zi (në disa komuna), u takuan me gjithësejt 251 pjesëmarrës.

Gjatë këtyre takimeve, përfaqësuesit e komuave/bashkive dhe autoriteteve të tjera lokale, patën rastin të merrnin më shumë informacione të detajuara mbi dy programet. Përpjekjet e SO dhe SPT për të organizuar këto lloj takimesh ishin shumë të mirëpritura dhe pjesëmarrësit ishin shumë të kënaqur me sasinë dhe cilësinë e informatave të dhëna.



Si rezultat i këtyre takimeve dhe vlerësimeve që u morren, 96.2% e pjesëmarrësve shprehën gadishmërinë e tyre të marrin pjesë në thirrjet e ardhshme për projekt propozime.

Gjatë takimeve u theksua si çështje për tu adresuar dhe trajtuar në të ardhmen kapaciteti i ulët i shumicës së komunave/bashkive në hartimin e projekt

propozimeve dhe zbatimin e projekteve në përputhje me rregullat e BE-së. Meqënëse ky ishte thelbi i diskutimeve gjatë takimeve, evenimente shtesë për rritjen e kapaciteteve me fokus komuna/bashkitë dhe institucionet respektive janë më se të nevojshme.



Ndryshimet në strukturën operuese të Malit të Zi

Me vendim të Qeverisë së Malit të Zi, datë 26 prill të vitit 2018, Ministria e Çështjeve të Evropës pushoi së ekzistuari dhe u krijua Zyra për Integrim Evropian. Zyra për Integrim Evropian mori të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë në lidhje me procesin e integrit të Malit të Zi dhe të gjitha çështjet e tjera të lidhura me BE, në përputhje me Organizimin e Brendshëm të Qeverisë së Malit të Zi, e cila u miratua nga Qeveria e Malit të Zi me 14 maj të vitit 2018.



Kancelaria za evropske integracije



FAKTE TË SHPEJTA – PROGRAMI IPA BNK MZ-SHQ DHE MZ-KOS 2014-2020

Strutura Operuese në Malin e Zi është e vendosur brenda Qeverisë së Malit të Zi – Zyra për Integrim Evropian (njësia BNK) dhe Ministria e Financës (Autoriteti Kontraktues).

Strutura Operuese në Shqipëri është Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Strutura Operuese në Kosovë është Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

**PROJEKTET E FINANCUARA NË
KUADËR TË THIRRJES SË PARE PËR
PROJEKT PROPOZIME TË
PROGRAMIT IPA BNK MAL I ZI –
SHQIPËRI 2014-2020**

Kontraktimi i projekteve të përzgjedhura nga thirrja e Parë për projekt propozime brenda programit Mali i Zi – Shqipëri përfundoi në prill të vitit 2018. Konkretisht, nën tre prioritetet tematike që mbulojnë turizmin dhe kulturën, trashigiminë natyrore, mbrotjen e mjedisit dhe punësimin, u zgjodhën 8 projekte:

- »»» “Ana Femërore” e cilësisë;
- »»» Turizëm miqësorë për fëmijët në rajonin ndërkufitarë;
- »»» Kuzhina lokale si ofertë turistike e rajonit ndërkufitarë;
- »»» Të rinjtë malazez dhe shqiptarë për kulturën e Lule Mjadrës;
- »»» Ruajtja e peisazheve kulturore në Shqipëri dhe Mal të Zi;
- »»» Ishujt e Gjelbër;
- »»» Rritja e bashkpunimit - nga antikitetet kristiane drejt përmirsimit të turizmit
- »»» Fatkeqsitë natyrore nuk njohin kufinj.

**FAKTE – THIRRJA 1-rë PROGRAMI IPA
BNK MZ-SHQ 2014-2020**

50% e granteve të akorduara si rezultat i thirrjes së Parë në programin IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri 2014-2020 janë brenda Prioritetit Tematik 1 - Inkurajimi i Turizmit, kulturës dhe trashigimisë natyrore.

**FAKTE – THIRRJA 1-rë PROGRAMI IPA
BNK MZ-SHQ 2014-2020**

Aplikuesit potencial në thirrjen e Parë për projekte kërkuar 9-të herë më shumë fonde


(912%) për projektet e tyre krahasuar me fondet e vëna në dispozicion.

“Ana Femërore” e cilësisë

Ky projekt zbatohet nga Komuna e Ulqinit, Grupi monitories Ulqin – MogUL, qendra UET dhe Bashkia Mirditë me një kohëzgjatje prej 18 muajsh. Projekti ka në fokus gratë e papunësuar, banoret të komuniteteve

rurale, bizneset (veçanërisht hotellet, restorantet dhe marketet) si dhe autoritetet lokale. Aktivitetet e projektit do zbatohen në

përfitime nga ky projekt. Konkretisht, nëpërmjet këtij projekti, përfqasuesit e industrisë së turizmit dhe OJF nga zonat



zonën e komunës së Ulqinit (Mal i Zi), dhe në rajonin e Lezhës (Shqipëri). Projekti do asistojë gratë e zonave rurale të marrin aftësitë e nevojshme dhe të përdorin potencialet agrikulturore të të dy vendeve. Kjo do arrihet nëpërmjet organizimit të një programi edukativ dhe trajnues në përputhje me nevojat e tyre, nëpërmjet vizitave studimore, dhe organizimit të panairove promovuese.



Pë më shumë informacion, klikoni [këtu](#).

**Turizëm miqësorë për fëmijët
në rajonin ndërkufitarë**

Shoqata për Prosperitet Demokratik – Zid nga Mali i Zi dhe Qendra Fëmijët Sot nga Shqipëria po zbatojnë projektin “Turizëm miqësorë për fëmijët në rajonin ndërkufitarë”, i cili do zgjasë 24 muaj. Ky projekt gjatë zbatimit të tij do të fokusohet në bashkpunimin me organizatat aktive në industrinë e turizmit, shoqërinë civile (OJF), komunat/bashkitë, media dhe turistët. Banorët e Ulqinit, Tivarit, Podgoricës, dhe Rozhajës në Malin e Zi dhe rajonit të Shkodrës dhe Lezhës në Shqipëri do kenë

ndërkufitare do të edukohen dhe ndërlihen në zhvillimin e ofertave të reja për turizmin e bazuar në komunitet. Aktivitetet kryesore do të synojnë rritjen e kapaciteteve për përfqasuesit e industrisë së turizmit dhe OJF-ve, zhvillimin e standarteve bazë për hapësira dhe mjete të ndryshme miqësore me fëmijët, shkëmbime eksperimentesh dhe njohurish, si dhe ndërhyrje në komunitetet e të dy vendeve.

Për më shumë informacion klikoni [këtu](#).

**FAKTE – Turizmi miqësorë me
fëmijët**

Turizmi miqësorë me fëmijët kombinon udhëtimet e pushimeve me ambientet e sigurta dhe interesante në përputhje me standardet dhe interesin e fëmijëve.

**Kuzhina lokale si ofertë
turistike e rajonit
ndërkufitarë**

Agjencia e Zhvillimit Rajonal në Bjelasica, Komovi dhe Prokletije, Organizata Kombëtare e Turizmit e Malit të Zi dhe Eco-Partners për Zhvillimin e Qëndrueshëm bashkë me Bashkinë Pukë nga Shqipëria po zbatojnë një projekt 24 mujor që trajton kuzhinën lokale si një ofertë turistike për komunat Berane, Andrijević, Plavë, Guci, Petnjicë and Rozhajë në Malin e Zi dhe bashkinë Pukë në Shqipëri.



Aktivitetet do të përfshijnë hotele, restorante dhe shtëpi të regjistruara turistike në zonën e targetuar, familjet rurale të rajonit, agjensitë turistike dhe organizatat aktive në promovimin dhe shitjen e paketave turistike të rajonit. Nëpërmjet aktiviteteve të tij, ky projekt do të përfshijë gastronominë lokale në një ofertë turistike për zonën ndërkufitare. Kjo do arrihet nga kërkimet në terren për gjetjen e recetave të vjetra dhe tradicionale, nëpërmjet standardizimit të recetave të vjetra, zhvillimit të librit udhërrëfyes mbi kuzhinën lokale, markimi i restoranteve lokale që ofrojnë gjellë tradicionale, krijimit të rrugës gastronomike dhe krijimin e zonave për ndalesë/shijimin e produkteve, ngritjes së kapaciteteve të familjeve të përfshira në këtë rrugë, krijimit të broshurës dhe faqes së internetit mbi rrugën gastronomike, përfshirja e pjesëmarrësve në projekt në rrjetin dhe fushatën promovionale "Slow Food".



Për më shumë informacion klikoni [këtu](#).

Të rinjtë malazez dhe shqiptarë për kulturën e Lule Mjadrës

Ky projekt zbatohet nga Komuna e Petnjicës, Asociacioni Kombëtarë i prodhuesve të Lule Mjadrës, shkolla e mesme Petnjica (Mali i Zi) dhe Shkolla e Mesme Profesionale Kombëtare "Ndre Mjeda" bashkë me OJF COSPE nga Shqipëria. Gjatë 18 muajve aktivitet, 40 të rinj e papunësuar, 20 maturan të dhe anëtarë të familjes së tyre nga Mali i Zi dhe Shqipëria do kenë mundësi të përmirsojnë njohuritë e tyre sipërmarrëse. Për më tepër, gjatë këtij projekti, pajisje dhe trajnime do ofrohen për personat e papunësuar gjë e cila do mundësojë rritjen e të ardhurave për familjet lokale. Gjithashtu do ofrohet këshillim dhe asistencë për

formimin e asociacionit të Lule Mjadrës në Petnjicë dhe Vaun e Dejës, si dhe do publikohet një manual për prodhuesit aktual dhe atyre të mundshëm në të ardhmen.



Për më shumë informacion klikoni [këtu](#).

Ruajtja e peisazheve kulturore në Shqipëri dhe Mal të Zi

Muzeu Polimje dhe Agjencia e Zhvillimit Rajonal në Bjelasica, Komovi dhe Prokletije nga Mali i Zi, në bashkpunim me Këshillin e Qarkut Shkodër dhe Euro Partners Development nga Shqipëria, do punojnë së bashku për zbatimin e projektit "Ruajtja e peisazheve kulturore në Shqipëri dhe Mal të Zi". Projekti ka kohëzgjatje prej 24 muaj dhe do bashkëpunojë me pronarët e shtëpive dhe bizneseve, autoritetet vendore, popullsinë e komuniteteve rurale të Beranes, Petnjicës, Andrijevicës, Plavës dhe Gucisë (Mal i Zi) dhe rajonit të Shkodrës (Shqipëri).

Citim i shkurtër – Rutja e peisazheve kulturore

"Peisazhet evropiane reflektjnë jo vetëm diversitetin klimatik dhe gjeologjik të kontinentit, por gjithashtu edhe ndërveprimin ndërmjet njeriut dhe natyrës." – *Peisazhet kulturore dhe trashigimia e biodiversitetit nga Agjencia Evropiane për Mjedis (EEA)*

Pronarët e shtëpive dhe të gjithë grupet e tjera të përfshira do kenë përfitime pasi projekti synon të ruaj arkitekturën tradicionale si një pjesë të rëndësishme të trashigimisë kulturore për këtë zonë ndërkufitare. Kjo do arrihet nëpërmjet përgatitjes së një studimi mbi arkitekturën tradicionale, projektimit të ndërtesave të reja që përdorin arkitekturë tradicionale, rekomandime për përmirsim të mundshme në godinat ekzistuese në mënyrë që të përshtaten më mirë me mjedisin, peisazhet kulturore të 4 komuniteteve dhe rehabilitimi i puseve/mullinjve me ujë, krijimit të një rruge kulturore që përfshin të paktën 10 ndërtesa tradicionale, ngritja e etno-odave në të

paktën dy komunitete lokale, kampeve të punës në komunitetet turistike rurale dedikuar arredimit të brendshëm me element tradicional.

Për më shumë informacion klikoni [këtu](#).

Ishujt e gjelbër

Komuna Berane dhe CARITAS i Malit të Zi, bashkë me VIS Albania dhe bashkinë Malësi e Madhe nga Shqipëria do zbatojnë projektin 30 mujor "Ishujt e gjelbër". Projekti do adresojë çështje lidhur me menaxhimin e mbetjeve dhe do përmirsojë standardet e qytetarëve në Berane dhe Malësi të Madhe.



Projekti synon të krijojë një sistem funksional për mbledhjen e diferencuar të mbetjeve, të forcojë kapacitetet e autoriteteve dhe institucioneve që merren me menaxhimin e mbetjeve dhe të informojë qytetarët mbi rëndësinë e grumbullimit të drejtë të mbetjeve. Kjo do të arrihet nëpërmjet trajnimeve dhe ligjeratave për të punësuarit në institucionet publike dhe shkollat e ciklit të ulët, nëpërmjet fushateve promovionale, aksioneve ambientaliste të shkollave të mesme, realizimit të një projekti pilot mbi seleksionimin e dy llojeve mbetjesh (komponent të thatë dhe të lagura), blerjes së pajisjeve për ndërmarrjet e mirëmbajtjes / ose policinë komunale, si dhe dizenjimit, krijimit dhe vendosjes së 16 Ishujve të Gjelbër.

Për më shumë informacion klikoni [këtu](#).

Ritja e bashkpunimit - nga antikitetet kristiane drejt përmirsimit të turizmit

Dioçeza e Budimlje dhe Nikshiq e Kishes Ortodokse Serbe dhe Muzeu Polimje nga Mali i Zi, në bashkpunim me Albania Community Assist dhe Institutin e Arkeologjisë, Qendra Shqipëtare e Studimeve nga Shqipëria, janë duke zbatuar projektin "Ritja e bashkpunimit - nga antikitetet kristiane drejt përmirsimit të turizmit" që do zgjasë për 36 muaj. Grupet që do përfitojnë nga aktivitetet janë ofruesit e shërbimeve turistike (lokal dhe ndërkombëtarë), institucionet kulturore dhe fetare, ekspertët e historisë dhe arkeologjisë,

media dhe studentët. Projekti do zbatohet në komunën e Beranes, rajonin e Shkodrës dhe në Hot të Kastratit, Malesia e Madhe.




Foto:

<http://www.ezonetoday.com/2018/01/What-is-AR-Augmented-Reality-How-it-works.html>

Vende arkeologjike (kulturore) të reja (të pashfrytzuara) do hulumtohen, gërmohen, ruhen dhe vlerësohen për qëllime turistike duke i kontribuar zhvillimit të turizmit në zonë. Konkretisht, do bëhet gërmimi, ruajtja dhe sinjalizimi turistik i dy vendeve arkeologjike në Mal të Zi dhe Shqipëri (Tumbarice castrum dhe Basilika Kristiane e Hotit në Kastrat, Malësia e Madhe). Gjithashtu, është parashikuar edhe ndërtimi i një rruge pedonale që të çon drejt Basilikës Kristiane (250 m), studimi dhe hartëzimi i rrugës që lidh fortesën Prevalis/Moesia Limes, si dhe dy kampe arkeologjike të përbashkëta rinore, një publikim shkencor shumëgjuhësh në lidhje me trashigiminë arkeologjike Kristiane dhe një aplikacion telefonik shumëgjuhësh ICT si udhëzues turistik i komunave/bashkive pjesëmarrëse.

Për më shumë informacion klikoni [këtu](#).

Fakte – Realiteti i shuar

Realiteti i shtuar është një version i përmirsuar i realiteti fizik, elementët e të cilit mbivendosen nga gjenerimi kompjuterik ose nxirren nga të dhënat ndijimore si tingujt, video dhe grafika ose të prekura. (Schueffel, Patrick *The Concise FINTECH COMPENDIUM*, 2017)

Fatkeqsitë natyrore nuk njohin kufinj

“Fatkeqsitë natyrore nuk njohin kufinj” është një projekt 24 mujorë zbatuar nga FORS Montenegro, Ministria e Punëve të Brendshme e Malit të Zi- Drejtoria për Emergjencat dhe Prefektura Shkodrër.

FAKTE - RRF

Reduktimi i Rrezikut të Fatkeqsive (RRF) është koncepti dhe praktika e reduktimit të rrezikut që vjen nga fatkeqsitë nëpërmjet përpjekjeve sistematike për të analizuar dhe reduktuar faktorët që shkaktojnë fatkeqsitë.

Reduktimi i ekspozimit nga fatkesitë natyrore, zvoglimi i cënueshmërisë së njerëzve dhe pasurive, menaxhimi i mirë i tokës dhe mjedisit, dhe përmirsimi i përgatitjeve dhe alarmimi në kohë për fatkeqsitë natyrore janë të gjitha shembuj të reduktimit të rrezikut nga fatkeqsitë.

Ekipi i projektit do punojë me punonjësit e komunave/bashkive, njësitë e mbrojtjes dhe shpëtimit, institucionet kombëtare të mbrojtjes dhe shpëtimit si dhe Drejtorinë për Menaxhimin e Emergjencave të Malit të Zi dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile të Shqipërisë. Gjithashtu, përfitimet e projektit do të prekin edhe Institutin Hidrometeorologjik dhe Sizmologjik të Malit të Zi dhe Institutin Hidrometeorologjik të Shqipërisë si dhe autoritetet lokale. Për më tepër, qytetarët dhe të rinjtë do kenë mundësinë të marrin pjesë në këto aktivitete dhe të mësojnë mbi mbrojtjen gjatë përmbytjeve, shpëtimit dhe reduktimin e rrezikut nga fatkeqsitë.



Foto: <https://bit.ly/2vWvGMV>


Projekti do zbatohet në komunat Podgoricë, Tivar, Ulqin dhe rajonin e Shkodrës. Projekti do të ketë ndikim të dukshëm nëpërmjet përmirsimit të mbrojtjes së njerëzve dhe zonave nga katastrofat, në radhë të parë përmbytjet, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve, ndërgjegjimit dhe bashkpunimit ndërkufitarë për reduktimin e rrezikut nga fatkeqsitë. Kjo do arrihet duke blerë pajisje për mbrojtjen nga përmbytjet dhe të sitemeve për alarmim e hershëm, trajnimeve dhe simulimeve për punonjësit e njësitë të emergjencave për rastet e përmbytjeve dhe ujrave të rrëmbëshëm, por edhe trajnimeve për për, nxënësit, studentët dhe komunitetin. Gjithashtu, aktivitete promovionale janë parashikuar për student dhe nxënësit nga shkollat e mesme. Për më tepër, është parashikuar edhe një protokoll bashkpunimi që përcakton një sistem të përbashkët alarmi dhe përditsimin e të dhënave mbi përmbytjet në zonën e Liqenit Shkodër si dhe një marrëveshje e përbashkët

për bashkpunim për rastet RRF në zonën ndërkufitare.

Për më shumë informacion klikoni [këtu](#).

HAPET ZYRA E ANTENËS SPT NË PRISHTINË

Që nga muaji prill i vitit 2018, filloj punën në Prishtinë, zyra e Antenës e Sekretariatit të Përbashkët Teknik të programit IPA II BNK Mal i Zi – Shqipëri dhe Mal i Zi – Kosovë 2014-2020.



Zyra e Antenës e Sekretariatit të Përbashkët Teknik është funksionale dhe e vendosur në Rrugën [Garibaldi Street](#) në qendër të qytetit të Prishtinës, Kosovë. Zyrta i projektit i angazhuar në zyrën e Antenës do jetë në dispozicion të aplikuesve potencial dhe përfituesve të projekteve të programit IPA II BNK Mal i Zi – Kosovë 2014-2020.

Instrumenti për Kërkimin e Partnerëve

Jeni duke kërkuar partner për një projekt të ri në kuadër të programit IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri ose programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë 2014-2020? Instrumenti ynë për kërkimin e partnerëve është i disponueshëm t'ju asistojë për gjetjen partnerëve. Ju lutemi që të plotësoni formularin e kërkimit të partnerit dhe publikoni informacionin në bazën tonë të të dhënave në mënyrë partnerët e tjerë të interesuar të kenë mundësinë të ju kontaktojnë. Klikoni [këtu](#) për qasje tek instrumenti për programin IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri 2014 - 2020.

Klikoni [këtu](#) për qasje tek instrumenti për programin IPA BNK Mal i Zi -Kosovë 2014-2020.

Takimet e mbajtura në kuadër të programit IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri dhe Mal i Zi - Kosovë 2014-2020

U mbajt takimi i Tretë i Komitetit të Përbashkët Monitorues i programit IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri 2014 - 2020

Takimi i Tretë i KPM për programin IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri 2014 – 2020 u mbajt me datë 13 Prill të vitit 2018 në Podgoricë. Gjatë këtij takimi u diskutua dhe është vendosur për fokusimin e thirrjes së Dytë.



Konkretisht, gjatë takimit u bë një prezantim i detajuar i analizës së rezultateve të synuara të projekteve të kontraktuara nën thirrjen e Parë dhe kontributi i tyre në përmbushjen e indikatorëve të programit. Pas kësaj, u bë një diskutim mbi arritjen e indikatorëve të programit dhe u prezantuan prioritetet tematike të propozuara, qëllimet specifike dhe përfituesit e targetuar për thirrjen e Dytë.

gjatë pjesës së dytë të vitit 2018 në kuadër të IPA Programeve të bashkëpunimit ndërkufitar Mal i Zi – Shqipëri dhe Mal i Zi – Kosovë 2014-2020.

Në takim morën pjesë përfaqësuesit e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Mal të Zi, Zyrës për Integrim Evropian e Malit të Zi, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Ekonomisë të Malit të Zi-Drejtoria për Financimin dhe Kontraktimin e Asistencës së BE-së, si dhe të Sekretariatit të Përbashkët Teknik të IPA programeve të bashkëpunimit ndërkufitarë Mali i Zi- Shqipëri dhe Mali i Zi – Kosovë 2014 – 2020.



Ndër të tjera, anëtarët e Komitetit të Përbashkët të Projektit, kanë diskutuar mbi planifikimin dhe kornizën kohore lidhur me hapjen e thirrjes së dytë për projekt-propozime në kuadër të IPA programeve të bashkëpunimit ndërkufitarë Mali i Zi-Shqipëri dhe Mali i Zi – Kosovë. Gjithashtu, gjatë takimit u vlerësua cilësia e aktiviteteve të zbatuara dhe rezultateve të projektit.

Aktivite për rritjen e kapaciteteve të përfituesve të projekteve

Gjatë muajve qershor dhe korrik të vitit 2018 një seri aktivitesh për ngritjen e kapaciteteve u organizua nga Autoriteti

Kontraktues (CFCU), Zyra për Integrim Evropian e Malit të Zi, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme e Shqipërisë dhe Sekretariati i Përbashkët Teknik.

Seminari mbi zbatimin e projekteve dhe trajnimi mbi prokurimet për përfituesit e granteve brenda thirrjes së parë për projekt-propozime në kuadër të programit IPA BNK

Mali i Zi- Shqipëri 2014 – 2020 janë organizuar me datë 5 dhe 6 qershor në Podgoricë (Mal i Zi). Seminari u drejtua nga CFCU-a dhe teknikisht u mbështet nga SPT-a. Qëllimi i seminarit ishte të jepte informacione themelore mbi rolin dhe përgjegjësitë e përfituesve të granteve në lidhje me detyrimet kontraktuale dhe anekset e kontratës, menaxhimin financiar dhe arkivat, raportimin, monitorimin, kontrollin dhe vizibilitetin dhe informacione mbi parimet e prokurimeve, përgatitjes së dokumentacionit të prokurimeve dhe informacione mbi tenderin e thjeshtë dhe procedurës konkurruese me negociim.



Në vijim të kësaj, SPT organizoi një trajnim dy ditor mbi raportimin, publicitetin dhe vizibilitetin për përfituesit e granteve brenda thirrjes së parë për projekt-propozime në kuadër të programit IPA BNK Mali i Zi-Shqipëri 2014 – 2020, me mbështetjen e Autoritetit Kontraktues të Malit të Zi (CFCU), Strukturave Operuese të Programit, Zyrës për Integrim Evropian të Malit të Zi dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë. Trajnimi u mbajt në Shkodër (Shqipëri) me datën 3 dhe 4 qershor të vitit 2018 dhe morën pjesë 23 përfaqësues të përfituesve. Në trajnim morën pjesë edhe përfaqësuesit e Autoritetit kontraktues nga Mali i Zi, Zyra për Integrim Evropian e Malit të Zi, Zyra për Kontrollin e nivelit të parë (FLCO) – Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Republikës së Shqipërisë, si dhe drejtuesja e programit në Delegacionin e Bashkimit Evropian në Mal të Zi.



Trajnimi kishte për qëllim ngritjen dhe përfocimin e kapaciteteve të përfituesve të granteve nga Thirrja së parë për projekt-propozime në kuadër të programit të bashkëpunimit ndër kufitar IPA Mali i Zi-Shqipëri 2014 – 2020, duke ju mundësuar atyre të kuptojnë rregullat e raportimit dhe përdorimin e duhur të metodave dhe



Takimi i Gjashtë i Komitetit të Përbashkët të Projektit u mbajt në Petnjicë

Takimi i Gjashtë i Komitetit të Përbashkët të Projektit u mbajt me 31 Korrik të vitit 2018 në Petnjicë (Mal i Zi). Gjatë takimit u diskutua mbi zbatimin dhe mbi aktivitetet e ardhshme

teknikave për publicitet dhe vizibilitet në përputhje me rregullat e BE-së.

Aktivitetet për rritjen e kapaciteteve të aplikuesve potencial

Gjatë muajve qershor dhe korrik të vitit 2018, Sekretariati i Përbashkët Teknik i IPA programeve të bashkëpunimit ndërkufitarë Mali i Zi - Shqipëri dhe Mali i Zi – Kosovë, në bashkëpunim me Zyrën për Integritet Evropian të Malit të Zi, Ministrinë e Financave në Mal të Zi – Drejtorinë për Financimin dhe Kontraktimin e Asistencës së BE-së (CFCU) dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë, ka organizuar dy trajnime treditore mbi ciklin e menaxhimit të projekteve (PCM) dhe dy punëtori – Klinikat e Projekteve, si pjesë e aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve të aplikuesve potencial para shpalljes së Thirrjes së Dytë për projekt-propozime në kuadër të IPA programit të bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi-Shqipëri 2014 – 2020.




Në periudhën nga 20 deri me 22 qershor 2018, trajnimi mbi ciklin e menaxhimit të projekteve është mbajtur në Berane (Mal të Zi), kurse nga data 27 deri me 29 qershor 2018, trajnimi është mbajtur në Lezhë (Shqipëri). Gjithësej në trajnim në mënyrë aktive morën pjesë 34 pjesëmarrës, të cilët përfaqësonin institucionet, komunat dhe OJQ-të nga zona e programit. Gjatë këtyre trajnimeve treditore të mbajtura në Berane dhe Lezhë, pjesëmarrësit patën mundësinë të mësojnë lidhur me bazat themelore mbi ciklin e menaxhimit të projekteve përmes punës praktike, shembujve, diskutimit në grupe, si dhe përmes pyetjeve dhe përgjigjeve. Po ashtu, përmes ushtrimeve në grup, pjesëmarrësit janë trajnuar në hartimin e formës së kornizës logjike dhe në përdorimin e atyre informatave gjatë plotësimit të pjesëve të caktuara në formën e aplikimit. Klinikat e Projekteve janë mbajtur në Podgoricë (Mali i Zi) me 10 korrik 2018 dhe në Shkodër (Shqipëri) me 12 korrik 2018. Gjithësej, në këto punëtori morën pjesë aktive 46 përfaqësues të autoriteteve/institucioneve kombëtare dhe lokale, institucioneve arsimore dhe shoqërisë civile nga zona e programit.



Qëllimi i punës ishte të përmirësojë kapacitetet e aplikuesve potencialë, sidomos të atyre që nuk ishin të sukseshëm në kuadër të thirrjes së parë për projekt-propozime në Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA Mali i Zi – Shqipëri 2014-2020, lidhur me procesin e përgatitjes së projekt-propozimeve përmes prezantimeve, diskutimeve dhe këshillimit mbi qasjen e drejtë të plotësimit të përshkrimit të projektit, formës së kornizës logjike dhe formularit të aplikimit, duke përfshirë edhe buxhetin. Aplikuesit potencialë kishin mundësinë të shtrojnë pyetje lidhur me aplikimin e tyre të mëparshëm dhe morën përgjigjet në përputhje me paketën e aplikimit dhe udhëzimet që janë përdorur gjatë thirrjes së parë për dërgimin e projekt-propozimeve në Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA Mali i Zi – Shqipëri 2014-2020. Po ashtu, atyre ju dhanë rekomandime mbi tejkalimin e gabimeve të zakonshme brenda seksioneve të ndryshme të aplikimit.

Është publikuar PRAG i Ri!

Udhëzuesi praktik i BE-së për Prokurimet dhe Grantet –Procedurat dhe udhëzuesi praktik (PRAG) 2018 është publikuar dhe është i aplikueshëm për procedurat ku njoftimi i kontratës /udhërrëfyti për aplikant është publikuar duke filluar nga data 2 Gusht 2018.



Për më shumë informacion lexoni dokumentin e ri dhe ndryshimet [këtu](#).

PROGRAMI I PUNËS PËR GRANTE - IPA BNK MAL I ZI - SHQIPËRI 2014-2020 ËSHTË PUBLIKUAR

Programi i punës për grante në Mal të Zi, i cili është prezantuar nga Ministria e Financave në Mal të Zi, përkatësisht nga Drejtoria për Financimin dhe Kontraktimin e Asistencës së BE-së, për programin e bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi- Shqipëri 2014 – 2020 në kuadër të Instrumentit për para-aderim 2014-2020 (IPA II) për thirrjen e dytë për projekt-propozime është shpallur dhe mund ta shkarkoni në linkun më poshtë:

WORK PROGRAMME

Programi i punës për grante parashikon dy prioritete tematike (TP), të cilët do të përfshihen brenda thirrjes së dytë për projekt-propozime: **TP 2 – Mbrotja e mjedisit, promovimi i ndryshimeve klimatike dhe masave për zbutjen e tyre, menaxhimi dhe parandalimi i rreziqeve; dhe TP 3 – Promovimi i punësimit, lëvizshmëria e krahut/ofertës së punës dhe përfshirjes kulturore dhe sociale nga të dy anët e kufirit.**

Shuma totale indikative e cila do të jetë në dispozicion në kuadër të thirrjes së dytë për projekt-propozime është 2,890,000.00€ (me bashkimin e IPA alokimeve financiare për vitin 2016 me vlerë prej 1,700,000.00 € dhe për vitin 2017 me vlerë prej 1,190,000.00 €). Shpallja e thirrjes së dytë për projekt-propozime është planifikuar për tremujorin e tretë të vitit 2018.

»» Strukturat Operuese të programit
klikoni tek ikona për të shkuar tek web
- faqja)



European Integration Office



Ministry of finance
Directorate for Finance and Contracting
of the EU Assistance Funds



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration



**SEKRETARIATI I PËRBASHKËT TEKNIK I IPA
PROGRAMEVE TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - SHQIPËRI DHE MALI I ZI - KOSOVË 2014-2020**

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra kryesore**
Adresa: Beogradska 17, 81 000 Podgorica, Mal i Zi
Telefon: + 382 20 240 784; + 382 20 240 631;

Sanja TODOROVIC

Drejtuese e Sekretariatit të Përbashkët Teknik
E-mail: sanja.todorovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Maja RADOVIC

Zyrtare për Prokurimet dhe Financat
E-mail: maja.radovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Nikola DJONOVIC

Zyrtar Projekti me Specializim në Komunikim
E-mail: nikola.djonovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Almir CAUSEVIC

Zyrtar Projekti me Specializim në IT
E-mail: almir.causevic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Petar BELADA

Asistent Administrativ
E-mail: petar.belada@jts-mne-alb-mne-kos.org

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Shkodër**
Adresa: Rruga Ndoc Çoba, Nr 1 Shkodër, Shqipëri
Telefon: + 355 22 80 20 80;

Andi ÇEKAJ

Zyrtar Projekti, Antenë
E-mail: andi.cekaj@jts-mne-alb-mne-kos.org

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Prishtinë**
Adresa: Garibaldi 23/10, 10 000 Prishtinë, Kosovë
Telefon: +383 38 222 202;

Gazmir RACI

Zyrtar Projekti, Antenë
E-mail: gazmir.raci@jts-mne-alb-mne-kos.org

www.cbc-mne-alb.org | www.cbc-mne-kos.org



Ky projekt është i financuar
nga Bashkimi Evropian